



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.1000/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Super Viva” sh.p.k. me adresë në Fushë Kosovë, zona industriale 4 (ish “Thertorja”), të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Y.B., kundër të paditurit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) - Inspektoratit i Punës, në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 815/18, të datës 15.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.09.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit “Super Viva” sh.p.k. me adresë në Fushë Kosovë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A.nr.815/18 të datës 15.02.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.815/18 të datës 15.02.2021, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Super Viva” Sh.P.K, me seli në Fushë Kosovë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr. prot.:329/2017 të datës 11.12.2017 dhe vendimi nr. prot. 97/2018 i datës 01.03.2018 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, lartësisë së shqiptimit të gjobës, me propozimin që të aprovohet ankesa e paditësit dhe të prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A.nr.815/18 të datës 15.02.2021, ashtu që në tërësi të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit ose çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditësi me datën 17.04.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi për konfliktin administrativ me të cilën ka kërkuar nga Gjykata anulimin e vendimit nr. prot.:329/2017 të datës 11.12.2017 dhe vendimi nr.prot. 97/2018 i datës 01.03.2018 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës me seli në Prishtinë. Me padi ka kërkuar që të aprovet si e bazuar padia e paditësit e ushtruar kundër vendimit të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës me të cilin, Inspektori i Punës në Ferizaj, në aplikim të nenit 32, paragrafit 1, sanksionuar me nenin 92, paragrafi 1 të Ligjit të Punës, si dhe nenin 7, paragrafi 5, nën-paragrafi 5.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. -7/2012 për përcaktimin e gjobave dhe shumave adekuate për shkeljet të Ligjit të Punës, i cili ka shqiptuar paditësit ndëshkimin me gjobë prej 6,000.00€ (gjashtëmijë euro) për shkak se gjoja mos pagesës së kompenzimit për shfrytëzim të pushimeve vjetore.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 09.09.2021, në prani të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të palës së paditur, dhe pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë vendimi i kontestuar nga ana e paditësit është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale. Gjykata gjeti se e paditura me vendimin e saj nr.prot. 97/2018 i datës 01.03.2018, ligjshëm ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të ngritura nga ana e paditësit dhe në mënyrë të drejtë ka vërtetuar vendimin e e organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës të identifikuar me nr. prot.:329/2017 të datës 11.12.2017.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Lidhur me vendosjen si në aktgjykim, gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka dhënë konstatimet faktike lidhur me parregullsitë ligjore të gjetura nga inspektorët e të paditurës, gjatë inspektimit tek paditësi.

Sa i përket pretendimeve ankimore se janë bërë shkelje të dispozitave të Konfliktit Administrativ dhe dispozitave të ligjit për Procedurën Kontestimore, pasi që gjykata e shkallës së parë, gjatë procedurës nuk i ka zbatuar drejt dispozitat e ligjit, Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të argumentuara në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në dispozitat ligjore në fuqi, ngase aktgjykimi i ankimuar rrjedh se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë

kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjithashtu Kolegji, konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka zbatuar drejt ligjin kur ka nxjerr konstatimin se e paditura me vendimin e saj 97/2018 të datës 01.03.2018, ligjshëm ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të ngritura nga ana e paditësit dhe në mënyrë të drejtë ka vërtetuar vendimin e e organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës të identifikuar me Nr. 329/2017 të datës 11.12.2017. Në këtë drejtim, Kolegji gjen se aktgjykimi i atakuar mbështetet në dispozitat ligjore, ku drejtë janë vërtetuar faktet se në vendimin kontestues të paditurës janë gjetur parregullsi nga lëmia e marrëdhënies së punës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, në drejtim të faktit se përlllogaritja e periudhës kohore për pushimin vjetor është bërë gabimisht pasi që në rastin e punonjësit I.K. pushimi vjetor ka qenë plotë 20 ditë – gjë që e bën vendimin kontestues të paligjshëm. Lidhur me pretendimet konkrete, Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se vendimi i organit administrativ me të drejtë konstaton se pala paditëse nuk ka paraqitur dëshmi për pjesën tjetër të pushimit vjetor, pasi që në vendim për punonjësin I.K. vet paditësja konstaton se *“pjesa e mbetur e pushimit vjetor të pashfrytëzueshëm ... duhet të shfrytëzohet jo më vonë se data 30 Qershor 2017”*. Pra pavarësisht pretendimeve se punonjësit i janë dhënë 20 ditë pune si pushim vjetor, punëdhënësit ka dështuar të ofrojë dëshmi për pjesën tjetër të pushimit siç thekson vet paditësi në vendimin për lejimin e pushimit vjetor. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në procedurën e inspektimit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, inspektorati i punës ka autorizim dhe detyrim që të shqyrtojë dhe inspektojë rregullsinë e dokumentacionit për këtë fushëveprim – e që në rastin konkret me të drejtë ka gjetur mospërputhje dhe mungesë të rregullsisë së evidencës së pushimeve vjetore të punëtorëve. Më tej, Kolegji gjen se inspektimi nga organi administrativ dhe vendimet e atakuara në procedurën administrative nuk kanë të bëjë vetëm me mungesë dëshmie për një punonjës, por i njëjti përfshinë një sërë shkeljesh nga dispozitat e ligjit të Punës, përfshirë edhe punonjës të tjerë si në vendimin kontestues.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe kjo Gjykate.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1000/22 datë 20.09.2023

**Kryetar i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova**